



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

MINISTRIA PËR DIALOG

Prishtinë, 10 tetor 2016
Nr.ref. 114 /2016

z. Damian Gjicknuri
Ministër i Energjisë dhe Industrisë
Republika e Shqipërisë

I nderuar Ministër Gjicknuri,

Në prag të takimit mes dy qeverive, të Republikës së Shqipërisë dhe të Serbisë, të paralajmëruar për tu mbajtur këto ditë në Serbi, dëshirojmë tju bëjmë me dije se është me interes që Qeveria e Shqipërisë në këtë takim të ngrit shqetësimet për moszbatimin e marrëveshjes së Brukselit për energjinë, e cila është arritur në vitin 2013, ndërsa obligimet zbatuese janë rikonfirmuar në marrëveshjen e datës 25 gusht 2015.

Sikurse që jeni njoftuar, Marrëveshja për energji e arritur në Bruksel mes Republikës së Kosovës dhe të Serbisë, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian dhe mbështetjes së SHBA-ve parasheh funksionimin e pavarur të KOSTT dhe si rezultat KOSTT dhe ENTSO-E kanë nënshkruar marrëveshjen për pavarësimin e KOSTT në tetor 2015. Mirëpo kjo marrëveshje po mbahet peng nga ana e Serbisë e cila ka bllokuar zbatimin për shkak të mosgatishmërisë për të regjistruar në Kosovë një kompani të re për furnizim të energjisë në pajtim me ligjet e Kosovës ashtu siç e përcakton marrëveshja, që në fakt shpreh mosgatishmërinë e Serbisë që respektoj pavarësimin e KOSTT sipas marrëveshjes të cilën e ka nënshkruar në Bruksel.

Bllokimi i pavarësimin të KOSTT nga Serbia, përkundër marrëveshjes së Brukselit, ka për pasoj edhe vonesat në fillimin e punës së linjës së interkoneksionit mes Kosovës dhe Shqipërisë si dhe është bërë pengesë edhe ndaj qëllimeve të procesit të Berlinit për bashkëpunim rajonal dhe lidhje infrastrukturore në Ballkanin perëndimor ku energjia përbënë një sektor vital.

Prandaj, mendojmë se është e rëndësishme që këto çështje të shtrohen në takimin në fjalë si dhe të kërkohet nga Serbia të zbatoj marrëveshjet e Brukselit me theks të veçantë në çështjen e

energjisë, që janë në dobi të normalizimit të marrëdhënieve fqinjësore mes dy shteteve, Kosovës dhe Serbisë si dhe paqes e stabilitetit në rajon.

Ju falënderojmë për mbështetjen e vazhdueshme në tejkalimin e sfidave, dhe jemi në dispozicion për çfarëdo shpjegimesh që i vlerësoni të nevojshme.

Me respekt,



Edita Tahiri
Ministre për dialog
Kryenegociatore në Dialogun e Brukselit

CC:

Blerand Stavileci, Ministër i Zhvillimit Ekonomik

Mustafë Hasani, Kryeshef i KOSTT

Engjëll Zeqo, Kryeshef Ekzekutiv i OST, Shqipëri

Fitim Krasniqi, Sekretar i Përgjithshëm në Zyra e Kryeministrit të Kosovës